

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Lux Elaraskin” SHPK

FORMIMI

Sot me datë 06.12.2025, u hartua akti i themelimit, bazuar në kërkesat e ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 “Për shoqëritë Tregtare” formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emertuar **“Lux Elaraskin” SHPK** e ortakëve themelues **z.Fatmir Shtjefni, me nr ID I00622031E**.

FORMA JURIDIKE

Forma juridike e shoqërisë është “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”.

KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

SELIA

Selia e shoqërisë **“Lux Elaraskin” SHPK** është: Tirane, Lagjia Yzberish, nr pasurie 369/28/N30, zk 3866.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë **“Lux Elaraskin” SHPK** është:

1. Import-Export, Tregti të produkteve kozmetike.
2. Çdo lloj aktiviteti tjetër të lejuar me ligj.

Të gjitha veprimtaritë e përshkruara me sipër mund të kryhen qoftë për llogari të shoqërisë vete ashtu dhe për llogari të të tretëve.

Kapitali i shoqërisë

Kapitali themelor i shoqërisë është 100 000 (LEK) .Të ndara në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve

z.Fatmir Shtjefni 100 % ose 100 000 leke

Organet drejtuese

Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë. Cdo ortak ka të drejte të marrë pjesë në asamble dhe të bëjë prezent opinionin e tij. Numri i votave të çdo ortaku është në raport me pjesën e tij të kapitalit në kapitalin themelor të shoqërisë.

Shoqëria tregtare **“Lux Elaraskin” SHPK** do drejtohet nga administratori z.Fatmir Shtjefni.

Në mardhënie me të tretet shoqëria përfaqësohet nga administratori. Në emer të shoqërisë firmos administratori i cili i bashkangjit emertimin tregtar të shoqërisë, emrin, mbiemrin dhe funksionin e tij. Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES

Fatmir Shtjefni

**Perfaqesuar me prokure nga
Fatjon Bushi**